

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML 121/2014

PPS 10/2013

26 qershor 2014

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova si kryetare e kolegjit, Gjyqtari i EULEX-it Willem Brouwer dhe Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Emine Mustafa si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtarja ligjore e EULEX-it Natalie Dawson duke vepruar në cilësi të procesmbajtëses,

Në lëndën penale kundër:

B [REDACTED] K [REDACTED], i lindur më [REDACTED] në Lladoc, emri i babait [REDACTED], shqiptar i Kosovës

I dyshuar për veprat penale në vijim:

1. **Vrasje** në shkelje të nenit 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tani e tutje KPPK) dhe Vrasje në tentativë në shkelje të nenit 146(10) të KPPK-së në lidhje me nenin 20 të KPPK-së;
2. **Vrasje e rëndë** në shkelje të nenit 147(10) të KPPK-së dhe Vrasje të rëndë në tentativë në shkelje të nenit 146 të KPPK-së në lidhje me nenin 20 të KPPK-së;
3. **Kryerja e veprave terroriste** në shkelje të nenit 110(1) dhe (3) së bashku me nenin 109(1), (10) dhe (12) të KPPK-së të dënueshme me së paku pesëmbëdhjetë (15) vite burgim;
4. **Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to** në shkelje të nenit 142(1)(3) të KPPK-së


Duke vendosur në lidhje me **kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë** të paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të B [REDACTED] K [REDACTED], të pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë më 9 qershor 2014;

Duke pasur parasysh mendimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPSHK-së) të paraqitur më 12 qershor 2014;

Pas këshillimit dhe votimit, në pajtim me nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale (tani e tutje KPP), Gjykata Supreme lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga B [REDACTED] K [REDACTED], **APROVOHET.**
2. Aktvendimi i Gjykatës Themelore i datës 23 maj 2014 ndryshohet sipas nenit 438(1.1) të KPP-së dhe kërkesa e Prokurorit për paraburgim në lidhje me B [REDACTED] K [REDACTED], **REFUZOHET SI E PABAZUAR.**
3. Paraburgimi i B [REDACTED] K [REDACTED] **ndërpritet menjëherë.**



ARSYETIM

Historia e procedurës:


1. Historia e procedurës

- d. Aktakuza PP nr. 276/04 është ngritur më 12 qershor 2006 kundër të pandehurit K [REDACTED].
- b. Më 9 nëntor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka dërguar aktgjykimin e formës së prerë duke refuzuar akuzat kundër të pandehurit K [REDACTED] ato akuzat që janë tërhequr nga Prokurori.
- c. Prokurori i PSRK-së ka lëshuar aktvendimin mbi fillimin e hetimeve për gjashtë të pandehur përfshirë të pandehurin K [REDACTED] të datës 18 shkurt 2013.
- d. Më 23 janar 2014, Prokurori ka paraqitur kërkesa për lëshimin e urdhrit për arrest kundër të pandehurit K [REDACTED] dhe dy të tjerëve. Prokurori gjithashtu ka paraqitur aktakuzat e mëparshme në lidhje me dy të pandehurit. Aktakuza në lidhje me të pandehurin K [REDACTED] është e datës 12 qershor 2006.
- e. Më 24 shkurt 2014, Prokurori është ftuar që ta plotësojë kërkesën me informata të mëtutjeshme të detajuara, elaborat për qëndrimin e tyre për parimin *ne bis in idem* dhe domosdoshmërinë që të shkohet përmes procedurës për rihapje.
- f. I pandehuri K [REDACTED] është arrestuar më 22 maj 2014 së bashku me të bashkëpandehurin F [REDACTED] E [REDACTED].
- g. Më 23 maj 2014, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka caktuar paraburgim ndaj të pandehurit K [REDACTED] prej një (1) muaji, i cili skadon më 22 qershor 2014.
- h. Më 9 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë ka pranuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 23 maj 2014.
- i. Më 12 qershor 2014, Prokurori i Shtetit ka paraqitur mendimin.
- j. Më 18 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë ka vazhduar paraburgimin kundër të pandehurit K [REDACTED] edhe për një (1) muaj, i cili skadon më 18 korrik 2014.
- k. Më 20 qershor 2014, Gjykata e Apelit ka pranuar pjesërisht ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit K [REDACTED] kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të datës 18 qershor 2014. Aktvendimi i Gjykatës Themelore është prishur dhe është kthyer në Gjykatën Themelore për vendim të mëtutjeshëm, i pandehuri K [REDACTED] të mbetet në paraburgim deri në lëshimin e aktvendimit tjetër.

2. Parashtrësit e palëve

Mbrojtja

- a. Gjyqtari i procedurës paraprake nuk ka vlerësuar ekzistimin e dyshimit të bazuar.
- b. Gjyqtari i procedurës paraprake nuk ka vlerësuar parimin *Ne Bis in Idem*.
- c. Aktgjykimi mbi refuzimin e akuzave ka të njëjtat pasoja sikurse aktgjykimi mbi meritat e lëndës.




- i. Trupi gjykues ka vleresuar meritat e lëndës sepse Prokurori i ka tërhequr akuzat. Akuzat kanë qenë *Res Judicata* dhe prandaj nuk mund të ketë dyshim të bazuar.

Prokurori i Apelit

- a. Veprat penale për të cilat kërkohet paraburgimi janë të njëjta sikurse ato që janë përshkruar në aktakuzën e datës 12 qershor 2006, të cilat ishin refuzuar pasi ishin tërhequr nga Prokurori.
- b. Prokurori i referohet aktvendimit të Gjykatës së Apelit më 30 maj 2014 (vetëm në lidhje me të bashkëpandehurin E [REDACTED]), dhe fton Gjykatën Supreme që të vendosë nëse parimet e ngritura aty janë të zbatueshme për këtë të pandehur.
- c. Prokurori nuk jep një mendim të qartë.

2. Gjetjet e Gjykatës:

- a. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme dhe e paraqitur me kohë.
- b. Kolegji ka shqyrtuar me kujdes vlerësimin e bërë nga gjyqtari i procedurës paraprake. Kolegji pajtohet se autoritetet e shtetit të cilat zhvillojnë këtë procedurë kanë për obligim që në secilën fazë të procedurës të vlerësojnë nëse eksitojnë rrethanat të cilat e ndalojnë ndjekjen penale dhe prandaj nëse parimi *ne bis in idem* është shkelur. Kolegji gjithashtu pajtohet se kjo është veçanërisht e rëndësishme kur paraburgimi mund të jetë, apo në këtë rast është, caktuar ndaj të pandehurit, paraburgimi është privim i lirisë së tij.
- c. Kolegji ka shqyrtuar formulimin e nenit 4(1) të KPP-së si dhe të nenit 4 të Protokollit Nr. 7 të Konventës së Gjenevës për të Drejtat e Liritë Themelore të Njeriut.
- d. Kolegji vëren se gjetjet e Gjykatës së Apelit në aktvendimin e saj të datës 30 maj 2014 në lidhje me formulimin e nenit 4(1) të KPP-së. Kolegji pajtohet me kolegjit e Gjykatës së Apelit se ekziston një dallim në mes të gjuhës në mes të versionit në gjuhën shqipe dhe angleze të KPP-së.
- e. Në versionin në gjuhën angleze në tekst thuhet, '...ose aktakuza është hedhur poshtë me vendim të formës së prerë të gjykatës' (me theks të shtuar). Në të njëjtën frazë në tekstin në gjuhën shqipe thuhet, 'ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës' (me theks të shtuar).
- f. Teksti origjinal i KPP-së (dhe gjuha në të cilën është votuar në Parlament) ka qenë gjuha shqipe. Prandaj, duhet pranuar se ky është versioni i saktë (sipas nenit 3 (2) të Ligjit në Gazetën Zyrtare – Ligji nr. 2004/47).
- g. Pavarësisht nëse ka pasur hedhje poshtë apo refuzim të akuzave të mëparshme, vendimi është referuar në dispozitat e nenit 4 (1) *supra* të natyrës procedurale. Nuk është vendim mbi meritat e lëndës penale pasi që i pandehuri as nuk është liruar e as nuk është dënuar.
- h. Neni 4 (1) i KPP-së, i cili përshkruar parimin *ne bis in idem*, i referohet ndjekjes apo dënimit për veprën penale për të cilën personi është liruar apo dënuar me vendim të formës së prerë. Prandaj, KPP-ja përsërit formulimin e nenit 4 të Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të aplikueshme në Kosovë me referim në nenin 2(2) të Kushtetutës së Kosovës. Ndryshe nga Konventa, KPP-ja përveç liritimit apo dënimit të formës së prerë i referohet vendimit të formës së prerë.



prerë të gjykatës me ane të cilit është refuzuar aktakuza. Njëra nga situatat hipotetike në të cilat kjo mund të ndodhë është kur Prokurori tërheq akuzat.

- i. KPP-ja e ndalon ndjekjen e dytë penale jo vetëm kur ka vendim të formës së prerë për meritat, por gjithashtu kur ka vendim të formës së prerë për natyrën procedurale i cili është marrë në bazë të tërheqjes me kërkesë të Prokurorit pa asnjë vlerësim substancial nëse është kryer krimi apo jo. Prandaj, KPP-ja ofron një regjim i cili është më i favorshëm për të pandehurin dhe për këtë arsye ky parim duhet të aplikohet.
- j. Në këtë lëndë të veçantë, ka pasur një aktgjykim të lëshuar nga gjykata e shkallës së parë më 9 nëntor 2007 sipas dispozitave të nenit 389 (1) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës së Kosovës, UNMIK/REG/2003/26 nga 6 korriku 2003. Me anë të aktgjykimit, në bazë të veprat e njëjta penale akuzat janë refuzuar sepse prokurori i kishte tërhequr ato. Është e parëndësishme se si janë cilësuar veprat në atë kohë dhe si janë cilësuar ato tani. Ajo që është e rëndësishme është identiteti i akteve materiale të cilat përbëjnë veprën. Nuk ka asnjë argument në këtë lëndë se edhe më herët e edhe tani akuzat kanë qenë të bazuara dhe janë bazuar në aktet e njëjta materiale. Prandaj, ndjekja e re nuk është mundur pasi që shkel parimin *ne bis in idem*.
- k. Kolegji vëren procedurën për rihapjen e procedurës penale në nenin 423(1.3) të KPP-së. Kolegji gjen se kjo dispozitë zbatohet vetëm kur rihapja e tillë do të ishte në dobi të të pandehurit. Prandaj, kolegji gjen se kjo procedurë nuk është e zbatueshme në lëndën në lidhje me të pandehurin K [REDACTED].
- l. Kolegji është në dijeni se pasi që aktvendimi i kundërshtuar është dërguar, gjyqtari i procedurës paraprake ka dërguar një tjetër aktvendim mbi vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit K [REDACTED]. Më tutje, ky aktvendim është apeluar nga avokati mbrojtës i cili përfaqëson të pandehurin K [REDACTED], e që ka rezultuar në anulimin e pjesshëm të aktvendimit. Lënda është kthyer në Gjykatën Themelore për vendim të mëtutjeshëm.
- m. Konstatimi i këtij kolegji është se parimi *ne bis in idem* është shkelur dhe i pandehuri K [REDACTED] duhet të lirohet menjëherë.

Kryetare e kolegjit:

Elka Filcheva-Ermenkova
Gjyqtare e EULEX-it



Procesmbajtëse:

Natalie Dawson
Zyrtare ligjore e EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

Willem Bouwer
Gjyqtar i EULEX-it

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

GJYKATA SUPREME E KOSOVES
PML 121/2014
26 qershor 2014

